



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCL-11-0035

Ankuesit

1. I J Mitrovicë
2. O R Prishtinë
3. G A Mitrovicë
4. M M Mitrovicë
5. N H Mitrovicë
6. F H, Mitrovicë
7. S I Vushtrri
8. N H Vushtrri
9. R H Mitrovicë
10. B B Mitrovicë
11. S Xh Vushtrri
12. Q G Vushtrri
13. Z R Mitrovicë,

Të gjithë të përfaqësuar nga Avokati Nexhat Beqiri, Vushtrri.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 14 tetor 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHEN** vendimet e Autoritetit të Likuidimit : **1.**MIT025-0015,i datës 24 mars 2011, **2.** MIT025-0047, i datës 01 prill 2011, **3.**MIT 025-0054, i datës 24 mars 2011, **4.** MIT 025-0055, i datës 24 mars 2011, **5.** MIT025-0057, i datës 01 prill 2011, **6.**MIT025-0058, i datës 24 mars 2011, **7.**MIT025 – 0051, i datës 01 prill 2011, **8.** MIT025-0053, i datës 24 mars 2011, **9.** MIT025 – 0050, i datës 24 mars 2011, **10.** MIT025-0048, i datës 01 prill 2011, **11.** MIT025-0052, i datës 24 mars 2011, **12.**MIT025-0049, **13.**MIT025-0080, i datës 01 prill 2011, **si të drejtë dhe të bazuar në ligj.**

II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 nëntor 2011, ankuesit ish punëtorë të NSh-së “Kosovasirovina” (në Likuidim) I J, O R, G A, M M, N H, F H, S , N H, R H, B B, S Xh, Q G dhe Z R, dorëzuan në Dhomën e Posaçme ankesë grupore kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën kanë kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara, secili në shumë prej nga 12.600.00 €, nga NSh-së “Kosovasirovina” (në Likuidim).

Ankuesit pohuan se ankesën e parashtruan për shkak të refuzimit të kërkesave të tyre për pagesën e pagave të papaguara në periudhat kohore prej vitit 1999 deri në fillim të likuidimit të NSh-së. Sipas ankuesve marrëdhënia e punës ju është ndërprerë në momentin e likuidimit, kështu që librezat e punës e bashkëngjitur në këtë ankesë është provë për secilin ankues për periudhën e saktë sa kanë punuar në këtë NSh.

Më tej ankuesit pohojnë se, besojnë në të drejtën për të kërkuar pagat për periudhën 1999 deri në momentin e likuidimit të ndërmarrjes, për faktin se në të gjitha njësitë e tyre në tërë Kosovën ku kanë punuar, i kanë marrë pagat, ndërsa ky grup që ka punuar në ndërmarrjen bazë ju është mohuar një gjë e tillë. Në fund kërkuan që të aprovohet kërkesa e grupit të punëtorëve të NSh Kosovasirovina dhe të obligohet komisioni i Likuidimit të AKP-së që të kompensoj – paguaj grupit të punëtorëve të lartë cekur në emër të pagave të pa paguara, shumat sipas kërkesës së tyre të bërë më herët dhe të përfshira në vendimet e tyre.

Në mbështetje të ankesës ankuesit kanë bashkëngjitur kopjen e librezës së punës, kopjen e formularit nga AKP me nr.148514-2006.

Me 12 tetor 2020, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesit nuk kanë ofruar ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tyre. Pala kundërshtare konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është ligjshmëria. Sipas mbrojtjes të hartuar nga e paditura, parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Komisionit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më tutje e paditura thekson se pala kundërshtare nuk ka dorëzuar kopje të vendimeve të kundërshtuara dhe provat që mbështesin ankesën e tyre, me tej shkresat e lëndës nuk përmbajnë asnjë dokument që mbështet shumat e kërkuara prej tyre apo rrogën mujore të gjithësecilit në momentin e likuidimit. Pretendimet e parashtrueseve të kërkesave janë të parashkruara, duke theksuar më tej se kërkesa ka të bëjë me paga të pa paguara për periudhën prej vitit 1999 deri në momentin e likuidimit. Nuk ka asnjë prove përpara këtij autoriteti të likuidimit që parashtruesit të kenë dorëzuar kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent. Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar, i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që “ pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre

vjet”. Si përfundim e paditura kërkon nga gjykata që të refuzoj ankesën si te papranueshme dhe te pabazuar dhe të vërtetoj vendimet e Komisionit të Likuidimit në pajtim me Nenin 74.4 te Ligjit nr.06/L-086.

Me 09 shkurt 2021, gjykata i ka dorëzuar përfaqësuesit të ankueseve një urdhër duke kërkuar nga ata që të parashtrinë prova shtesë ndaj ankesës se datës 24 nëntor 2011.

Me 26 shkurt 2021, përfaqësuesi i ankueseve ka paraqitur përgjigjën në urdhër në të cilin ka mbështetur si prova shtesë kopjen e vendimeve me numër si ne vijim: **1.** MIT025-0015, i datës 24 mars 2011, **2.** MIT025-0047, i datës 01 prill 2011, **3.** MIT 025-0054, i datës 24 mars 2011, **4.** MIT 025-0055, i datës 24 mars 2011, **5.** MIT025-0057, i datës 01 prill 2011, **6.** MIT025-0058, i datës 24 mars 2011, **7.** MIT025 – 0051, i datës 01 prill 2011, **8.** MIT025-0053, i datës 24 mars 2011, **9.** MIT025 – 0050, i datës 24 mars 2011, **10.** MIT025-0048, i datës 01 prill 2011, **11.** MIT025-0052, i datës 24 mars 2011, **12.** MIT025-0049, **13.** MIT025-0080, i datës 01 prill 2011.

Përfaqësuesi i ankuesëve në parashtrinë ka theksuar se ankuesi M M ka vdekur me datën 05 shkurt 2020, tutje si përfaqësues ligjor është lajmëruar bashkëshortja e të ndjerit Qefsere Mehmeti e cila e ka autorizuar avokatin N B për përfaqësim. Si provë përfaqësuesi i ankuesit ka sjellë Autorizimin e datës 19.02.2021, certifikatën e vdekjes së M M, Certifikatën e martesës e datës 20.02.2020, kopjen e letërnjoftimit, njoftimin lidhur me parashtrimin e kërkesës për kompensim me nr.0033/10, e datës 29.10.2010.

Ndërsa sa i përket ankuesit N H sipas përfaqësuesit të ankuesëve ai është zhdukur që nga muaji qershor i vitit 2019 dhe tani e tutje si përfaqësues ligjor është lajmëruar djali i të ndjerit-B H i cili e ka autorizuar me shkrim avokatin në fjalë që të përfaqësoj atë në procedurë. Si provë avokati ka bashkëngjitur autorizimin e datës 23.02.2021, kopjen e letërnjoftimit dhe kopjen e librezës se punës në emër të N H.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur

parashtreras apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesit kanë qenë punëtorë të NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesit nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojnë se NSH-ja u ka mbetur borxh ndonjë pagë gjatë periudhës së kërkuar, poashtu nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi lidhur me periudhën dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesit kanë dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së tyre edhe pas parashtrimit të urdhërit të datës 09 shkurt 2021 të lëshuar nga DHPGJS, duke sjellur vetëm vendimet e atakuara me ankesë. Poashtu, për kërkesat e tyre lidhur me shumën dhe lartësin e pagave, nuk kanë bashkangjitur listë të pagave apo ndonjë provë që do ta vërtetonte lartësin e pagës mujore apo shumën e përgjithshme të kërkuar. Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesit e ankesës nuk i kanë përmbushur kriteret themelore të ankesës. Librezat e punës të dorëzuara nga ankuesit nuk mund të shërbejnë si provë e vetme për t'ua njohur të drejtat e pretenduara në ankesë. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesve lidhur me të drejtën e tyre në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Sa i përket parashkrimit të kërkesës të cilën ankuesit e kanë arsyetuar, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimit është institut i veçantë me afate të përcaktuara me ligj e të cilat nuk do të ishte fare e vështirë të përcaktohen, por në këtë rast kur kemi të bëjmë me kërkesën për pagat e papaguara për kohën sa nuk kanë punuar ankuesit, kjo është kërkesë e pa aplikueshme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, me

22 korrik 2021, ankuesit kanë bërë pagesën e taksës gjyqësore në mënyrë solidare, në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohen me taksa shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e

Hajrie Shala